



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 7489 Prot.

Tiranë, më 26.07. 2019

URDHËR

NR. 413, DATË 26.07. 2019

PËR

PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR APLIKIMIN, PROCEDURAT, AFATET DHE DOKUMENTACIONIN PËR T'U BËRË PJESË E REGJISTRIT SHTETËROR TË MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE E TË KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 11, nenit 26 dhe pikës 5 të nenit 49 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 104, datë 28.2.2019, "Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë",

URDHËROJ:

1. Përcaktimin e rregullave për "Aplikimin, procedurat, afatet dhe dokumentacionin për t'u bërë pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë", sipas tekstit bashkëlidhur dhe që është pjesë e këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri: Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

MINISTËR

Besa SHAHINI



Rregullat për aplikimin, procedurat, afatet dhe dokumentacionin për t'u bërë pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë

1. Regjistri shtetëror i mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë administrohet, përditësohet dhe ruhet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), si institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë.
2. Regjistri shtetëror i mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë është sipas formatit të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 104, datë 28.2.2019, "Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë";
3. Mësuesit e gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë (më poshtë kandidatët) që dëshirojnë të bëhen pjesë e regjistrit shtetëror duhet të dorëzojnë dokumentacionin me rrugë postare ose me rrugë elektronike brenda afateve të përcaktuara nga ASCAP.
4. ASCAP gjatë muajit tetor të çdo viti kalendarik, shpall kërkesën për aplikime dhe afatet e aplikimit.
5. Dokumentacioni dorëzohet në adresën postare të ASCAP, ose në adresën elektronike e cila bëhet e ditur në faqen zyrtare të ASCAP.
6. Dokumentet që duhet të paraqesin kandidatët janë:
 - a) Kërkesë për aplikimin sipa shtojcës I bashkëlidhur.
 - b) Curriculum vitae me fotografi sipas formatit EUROPASS, shoqëruar me dokumentacionin që vërteton të dhënat në CV.
 - c) Kopje e një dokumenti identifikimi: pasaportë, apo kartë identiteti.
 - d) Kopje e diplomës, në fushën e mësuesisë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar (bachelor dhe master ose e integruar).
 - e) Kopje e listës së notave, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.
 - f) Kopje e licensës së mësuesisë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar (nëse disponon një të tillë).
 - g) Kopje të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara të certifikatave dhe të kualifikimeve si mësues të gjuhës shqipe, të marra në Shqipëri ose në vende të tjera.
 - h) Dokument që vërteton që kandidati jep mësim në gjuhën shqipe, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar (të saktësohet nëse është institucion publik ose privat, nëse është punë me kohë të plotë ose të pjesshme).
7. Për administrimin e dokumentacionit dhe shqyrtimin e aplikimeve, ASCAP formon grupin teknik të përbërë me personel administrativ të institucionit. Ky grup kryen detyrat si vijon:
 - a. është përgjegjës për të ndjekur, administruar, verifikuar dhe vlerësuar dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët;
 - b. njofton kandidatët me e-mail për dokumentet shtesë që mund të duhen, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e aplikimit. Kandidati plotëson dokumentacionin brenda 3 ditëve kalendarike nga njoftimi për plotësim dhe e dërgon në rrugë elektronike.
 - c. njofton kandidatët që plotësojnë kushtet për t'u bërë pjesë e regjistrit shtetëror, pas miratimit të listës nga ministri përgjegjës për arsimin, si dhe ata të cilët nuk plotësojnë kushtet për t'u bërë pjesë e tij.
 - d. harton listën e mësuesve që plotësojnë kriteret e përcaktuara për t'u bërë pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare;

8. ASCAP dorëzon në ministrinë përgjegjëse për arsimin listën e mësuesve që janë pjesë e regjistrimit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.
9. Të dhënat e mësuesve që figurojnë në listën e miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin hidhen nga ASCAP, në regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.
10. Ministria përgjegjëse për arsimin i dërgon zyrtarisht ministrit përgjegjës për diasporën listën e miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin të mësuesve që bëhen pjesë e regjistrimit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2679 Prot.

Tiranë, më 10.5. 2021

URDHËR

Nr. 90, datë 10.5. 2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 413, DATË 26.07. 2019
“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR APLIKIMIN, PROCEDURAT,
AFATET DHE DOKUMENTACIONIN PËR T’U BËRË PJESË E REGJISTRIT
SHTETËROR TË MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE E TË KULTURËS
SHQIPTARE NË DIASPORË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 11, nenit 26 dhe pikës 5 të nenit 49 të ligjit 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.104, datë 28.2.2019 "Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë",

URDHËROJ:

1. Në "Rregullat për aplikimin, procedurat, afatet dhe dokumentacionin për t'u bërë pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë", bashkëlidhur dhe pjesë e urdhrin nr.413, datë 26.07.2019, bëhen këto ndryshime:
 - a) Pika 4 ndryshon si më poshtë:
"4. ASCAP gjatë muajit maj të çdo viti kalendarik, shpall kërkesën për aplikime. Afati i përfundimit të aplikimit të jetë deri në datë 30 shtator të çdo viti".
 - b) Shkronja g) dhe h) e pikës 6 ndryshojnë si më poshtë:
"g) Kopje të certifikatave dhe kualifikimeve si mësues të gjuhës shqipe, të marra në Shqipëri ose vende të tjera, nëse kanë.
h) Dokument që vërteton që kandidati jep mësim në gjuhën shqipe, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar (të saktësohet nëse është institucion publik ose privat, nëse është punë me kohë të plotë ose të pjesshme), me përjashtim të rasteve kur ky dokument lëshohet nga përfaqësitë diplomatike".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

MINISTËR
EVIS KUSHI



Shtojcë 1: Model kërkesë për kandidatët

Kërkesë aplikimi

Drejtuar: Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), Tiranë

Unë i nënshkruari _____ kërkoj të jem pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesëve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë. Më poshtë janë të dhënat e mia personale. Mbjaj përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e këtyre të dhënave.

EMËR, ATËSI, MBIEMËR:	
ADRESA:	
TELEFON:	
EMAIL:	
NUMRI PERSONAL I IDENTIFIKIMIT:	
VENDLINDJA:	
VENDBANIMI:	
DIPLOMIMI:	
Vendi ku jeni diplomuar:	
Emërtimi i institucionit të lartë ku jeni diplomuar:	
Lloji i institucionit ku jeni diplomuar (publik/privat):	
Lloji i diplomës (Bachelor/Master/Diplomë e integruar etj):	
Fusha ku jeni diplomuar (Emërtimi i diplomës) dhe viti i diplomimit:	
Lloji i kualifikimit në mësuesi, në vendbanim ku ushtroni detyrën e mësuesit:	
VITET E PUNËS:	
Vite pune në mësuesi në vendbanimin tuaj më siguracion të rregullt:	
Vite pune në mësuesi në vende të tjera më siguracion të rregullt:	
Jeni diplomuar si mësues në Shqipëri (po ose jo):	
Lloji i diplomës në mësuesi në Shqipëri (emërtimi i diplomës):	

Viti kur jeni diplomuar si mësues në Shqipëri:	
Vite pune në mësuesi në Shqipëri me siguracion të rregullt:	
Kategoria e kualifikimit nëse keni marrë një të tillë në Shqipëri:	
Emërtimi i institucionit ku jepni mësim:	
Lloji i institucionit ku punoni (publik/privat):	
Institucioni ku punoni është në varësi të shtetit ku banoni (po/jo):	
Institucioni ku punoni është në varësi të shtetit shqiptar (po/jo):	
Punoni me kohë të plotë (po/jo):	
Punoni me kohë të pjesshme (po/jo):	

Bashkëlidhur janë dokumentet:

- Curriculum vitae me fotografi sipas formatit EUROPASS.
- Kopje e nje dokumenti identifikimi: pasaportë, apo kartë identiteti.
- Kopje e diplomës, në fushen e mësuesisë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar (bachelor dhe master ose e integruar).
- Kopje e listës së notave, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.
- Kopje e licensës së mësuesisë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar (nëse disponon një të tillë).
- Kopje të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara të certifikatave dhe të kualifikimeve si mësues të gjuhës shqipe, të marra në Shqipëri ose në vende të tjera (*nëse e disponon një të tillë*).
- Dokumenti që vërteton që kandidati jep mësim në gjuhën shqipe, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar (*të saktësohet nëse është institucion publik ose privat, nëse është punë me kohë të plotë ose të pjesshme*) me përjashtim të rasteve kur ky dokument, lëshohet nga përfaqësitë diplomatike.